

2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE

PROJEKTVENDIM

Nr. ____, DATË, ____/____/202__

PËR

**MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 99
DATË 30.03.2023, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI
I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUND I RI,
OBJEKTET E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE
E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019", I NDRYSHUAR.**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë" të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019, "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", të ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 "Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës", i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr.164, datë 26.05.2020 "Për ngritjen e komsionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit" i ndryshuar me urdhërin 222 datë 06.07.2020, Raportit me nr. 14510 prot. datë 12.12.2024 të Komisionit të Posaçëm si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimi i disa shtesave në Tabelën 3 bashkalidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 99 datë 30.03.2023, përsa i përket listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr.31, Njësia Administrative Katund i Ri, Rruga “Bisht Kamëz”, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, si më poshtë vijon:

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
13	HAXHIRE PILAJ, GEZIM PILAJ, SKENDER PILAJ, MERSE PILAJ	1	1+1
14	FIJE SELMANI	1	1+1

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, ”Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtör

Alneida Rroshi



KOMISIONI I POSAÇËM


Kryetar

Gentian Kallmi



KRYETAR

Emiriana Sako





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KOMISIONI I POSAÇËM**

RELACION

PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 99 DATË 30.03.2023, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUND I RI, OBJEKTET E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019", I NDRYSHUAR

Të nderuar këshilltarë.

Referuar Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë" të ndryshuar, Aktin Normativ nr. 9, datë datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019, "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", të ndryshuar. Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 "Për ngritjen e Zyrës së Posaçmetë Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës", i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr.164, datë 26.05.2020 "Për ngritjen e komsionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit" i ndryshuar me urdhërin 222 datë 06.07.2020, Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr.104 datë 08.07.2022, Raportit me nr. 14510 prot. datë 12.12.2024 të Komisionit të Posaçëm miratuar nga kryetari i bashkisë, Komisioni i Posaçëm në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve

Legjislacionit në fuqi pas vlerësimit të dokumentacionit të të gjithë aplikantëve harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit për Pallatin Nr.31 Rruga “Bisht Kamëz”, në Njësinë Administrative Katund i Ri, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, sipas relacionit si më poshtë vijon:

Me Vendimin nr. 99 datë 30.03.2023, Këshilli Bashkiak ndër të tjera ka miratuar edhe listën e përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit, në Njësinë Administrative Katund i Ri, objektet e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, hartuar nga Komisioni i Posaçëm sipas tabelës 1, 2, 3 bashkëlidhur këtij vendimi.

Duke qënë se ASHK vijon me kthimin e përgjigjeve lidhur me konfirmimin e pronësisë, si dhe plotësimin e dokumentacionit nga Njësia Administrative Katund i Ri, Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ka kryer shqyrtimin dhe kualifikimin e dosjeve të pronarëve të apartamenteve respektive për Pallatin Nr.31 Rruga “Bisht Kamëz”.

Ky dokumentacion dhe kjo listë e subjekteve përfituese i vihet në dispozicion Komisionit të Posaçëm nga Zyra e Posaçme e Rindërtimi, nëpërmjet :

Raportit nr.13436 prot. datë 15.11.2024 për pallatet e ndodhura në Njësinë Administrative Katund i Ri ku:

1. Për Pallatin Nr.31 Rruga “Bisht Kamëz” ku kanë kualifikuar dy subjekte përfituese nga të cilat një subjekt ka aplikuar në platformën “Shtëpia ime” duke marrë gjendjen familjare të datës së aplikimit, si edhe një subjekt që nuk ka bërë aplikim tek platforma “Shtëpia Ime”. Lidhur me një subjekt që nuk ka bërë aplikim tek platforma “Shtëpia Ime”, Zyra e Posaçme e Rindërtimit ka shqyrtuar dhe e ka kualifikuar, duke marrë parasysh përbërjen familjare të datës 26 nëntor 2019.

Kjo listë e subjekteve përfiton nga programi i procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve mbi disa programe të procesit të rindërtimit”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin e sipërpërmendur dhe procedurën e ndjekur nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike, Komisioni i Posaçëm i kërkon Këshillit Bashkiak:

1. Miratimi i disa shtesave në Tabelën 3 bashkalidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 99 datë 30.03.2023, përsa i përket listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr.31, Njësia Administrative Katund i Ri, Rruga “Bisht Kamëz”, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, si më poshtë vijon:

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
13	HAXHIRE PILAJ, GEZIM PILAJ, SKENDER PILAJ, MERSE PILAJ	1	1+1
14	FIJE SELMANI	1	1+1

KOMISIONI I POSAÇËM:

Gentian

Kallmi

Kryetar

Robert Dervishi

Anëtar

Andri

Cerri

Anëtar

Diana Mandia

Anëtare

Klarita

Agasi

Anëtare

Lorenc Facja

Anëtar

Afroviti

Manthjo

Anëtare

Denis Balla

Anëtar